

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr. Nr./No: 08-1783
Data/Datum/Date: 24/09/2020
Shtojca/Dodaci/Annex: -4-

PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira - Departmant Slobodnih Profesija - Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/ The Disciplinary Comitee

Nr.04//2020

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUES PRIVAT, në përbërje të Xhemil Elshani kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj I _____, si organ përmbarues, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren,, e dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.4 të LPP-së, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë për profesionet e lira- Divizioni për Noteri dhe Përmbarues privat Fadilete Hoxha-, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, të palës ankuese "Aldex Qeramika sh.p.k" nga Prishtina, të cilën e përf. av. Ram Palushaj nga Prishtina, si dhe _____ me të autorizarin e saj Urim Vokshi nga Prishtina, pas mbajtjes së seancës për këshëllim dhe votim të mbajtur me dt. 23.06.2020, muar këtë:

V E N D I M

- I. Organi përmbarues - _____, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, është përgjegjëse për shkelje disiplinore, nga neni 365 par.1, neni 367 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 të LPP-së,
- II. Për shkeljen disiplinore të kryer, nga Organi përmbarues - _____ e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, i shqiptohet masa disiplinore **gjobë në të holla** në shumën prej 1,000.00 € (njëmijëeuro), në bazë nenit 368 par.1, pika 1.3 të LPP-së.
- III. Organi përmbarues - _____ e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, **obligohet** që gjobën në të holla si në pikën dy të dispozitivit të këtij vendimi, në shumën prej 1,000.00 € (njëmijëeuro), në emër të masës disiplinore, t'ia paguaj në llogari të buxhetit të Republikës së Kosovës bazuar në par.3 të nenit 368 të LPP-së.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë, - Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbaues Privat me dt.12.03.2020, ka paraqitur propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj Organit përmbaues – _____, e emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, si e dyshuar për shkelje disiplinore gjatë ndërmarrjes të veprimeve procedurale sipas lëndës përmbauese P.nr.05/2020 lidhur me mos dhëjen e mundësisë palës ankuese për parashtrimin e prapësimin ndaj urdhërit për përmbaues P.nr. 05/2020.

Në kuptim të dispozitave të nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MD.nr. 09/2014 komisioni disiplinor ka caktuar seancën dëgjimore, me dt. 23.06.2020 në ambientet - zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë të gjitha palët në procedurë si ankuesi- përfaqësuesi i “Aldex Qeramika sh.p.k” nga Prishtina, _____ si dhe i autorizuar i saj av. av. Urim Vokshi, si dhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbauesit privat Fadilete Hoxhaj në cilësinë e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Komisioni disiplinor, me qëllim të vërtetimit të plot dhe të drejtë të gjendjes faktike ka bërë dëgjimin e të gjitha palëve në procedurë, shqyrtimin e provave përmes leximit të të njëjtave, ashtu edhe të shkelësit disiplinor- përmbauesit privat në pajtim me nenin 7 par. 5 të UA-MD.nr.,09/2014.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 23.06.2020 kryesuesi i komisionit disiplinor, në fillim të seancës dëgjimore ija ka dhënë mundësinë shkelësit disiplinor respektivisht përmbauesit privat, që të deklarohet lidhur me përgjegjësinë disiplinore për pranimin e përgjegjësisë, në pajtim me nenin 7 par. 3 UA- MD.nr. 09/2014, për procedurën disiplinore me çrast përmbauesi privat ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar.

Pasi që përmbauesi privat nuk e ka pranuar përgjegjësinë disiplinore për shkeljen e pretenduar, pas kësaj procedura dëgjimore ka vazhduar me përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë duke e shtjelluar propozimin dhe provat tjera përkitazi me çështjen në fjalë, si dhe parashtrimin e propozimit për procedurë disiplinore ndaj organit _____ si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Prizren, e e dyshuar për shkelje të veprimeve disiplinore nga neni 367 par. 1 nën par. 1.2 dhe 1.10 si dhe mos përmbajtjes së veprimeve procedurale ligjore të parapara me nenin 18 dhe 47 të LPP-së me çrast edhe ka bërë shkelje edhe të nenit 110 të LPK-së.

Përmbauesja private në përgjigjen saj me shkrim të dt. 29.04.2020 të parashtruar ndaj ankesës së ankuesit ka deklaruar lidhur me çështjen në fjalë, se me të pranuar të propozimit për përmbaues nga ana e kreditorit, kam vepruar dhe lejuar propozimin sipas dokumentit të besueshëm dhe kam dërguar shkresat e lëndës dhe urdhërinë përmbaues përmes postës në adresë të dhënë të palës debitorë në këtë rast të ankuesit që ka qenë e shënuar në shkresat e lëndës, për çka më vonë jemi njoftuar se adresa e debitorit është e pa sakt, për çka e kam njoftuar kreditorin dhe ai në përgjigjen

e tij me shkrim e ka njoftuar përmbaruesin privat se adresa e debitorit është po ajo e njëjta dhe ka kërkuar që të vazhdohet me procedim të më tutjeshme. Procedimi lidhur me këtë çështje ka vazhduar në kuptim të dispozitave të LPK-së, dhe debitorit ia kemi dërguar të gjitha shkresat e lëndës dhe urdhërinë përmbarues në Email zyrtar dhe për të qenë në rregull për këtë kemi afishuar të njëjtën edhe në tabelën zyrtare të përmbaruesit privat dhe ate në kuptim të nenit 114 të LPK-së. Për çka është konsideruar se dorëzimi është bërë i rregullt dhe i paraparë sipas ligjit. Ku edhe është bërë bllokimi i llogarisë të debitorit.

Pala ankuese sikurse në propozimin për fillimin e procedurës disiplinore edhe në seancën dëgjimore ka deklaruar dhe kërkuar nga komisioni disiplinor që përmbaruesja private, e njëjta të shpallet se është përgjegjëse për shkeljet disiplinore dhe të njëjtës ti shqiptohet masa disiplinore e paraparë me nenin 368 të LPP-së, nga se e njëjta gjatë veprimeve procedurale –përmbarimore ka lëshuar urdhër me shkrim për lejimin e përmbarimit pa e njoftuar parapakisht palën debitore në këtë rast ankuesin, me propozimin për përmbarim, dhe as pa ju dhënë mundësia debitorit në këtë rast ankuesit për parashtrim të prapësimit ndaj urdhërit për përmbarim.

Gjatë seancës dëgjimore të dt. 23.06.2020 përmbaruesi privat dhe i autorizuari i saj kanë kërkuar nga komisioni disiplinor që parapakisht të shqyrtohet afatshmëria e fillimit të procedurës disiplinore pasi që udhëzimi administrativ nr. UA-nr. 09/2014 për procedurën disiplinore ndaj përmbaruesit privat neni 3 par. 10 parasheh që procedura disiplinore duhet të përfundoj në afat prej 3 muajve nga dita e paraqitjes së propozimit, siç u bë e ditur nga shtjellimi i propozimit ky propozim është paraqitur me dt. 12.03.2020. Derisa sa i përket deklarimeve të ankuesit deklarojnë se përmbaruesi privat lidhur me këtë çështje nuk ka bërë asnjë shkelje disiplinore për faktin se urdhërin për përmbarim P.nr.05/2020 të nxjer me dt. 13.01.2020 e ka dërguar tek debitori përmes postës në adresë zyrtare e cila figuron pran agjencionit për regjistrimin e bizneseve, gjegjësisht i njëjti urdhër është afishuar në tabelë zyrtare. Deklarojë se tani lënda në fjalë sipas prapësimit gjendet në Gjykatën Kompetente për të vendosur përkritazi me prapësimin.

I autorizuari i përmbaruesit privat av. Urim Vokshi shton se palës debitorë me kohë janë dërguar të gjitha shkresat e lëndës përkritazi me përmbarimin në adresën e parashtruar dhe ate në përputhje me dispozitat e nenit 18 të LPP-së, meqenëse pala debitorë ka qenë i pa çasshëm në adresën e ftuar, meqenëse i njëjti nuk e ka njoftuar përmbaruesin për adresën e re, afishimi i shkresave të lëndës së përmbarimit është bërë në tabelën e shpalljeve në zyrën e përmbarueses private e rregulluar me nenin 114 të LPK-së, ku debitori në afat ligjor nuk ka parashtruar prapësim, andaj urdhëri për përmbarim është bërë i formës së prerë, me çrast edhe përmbaruesja private ka vepruar në kuptim të ligjit për përmbarimin, për çka edhe e ka bërë bllokimin e llogarisë debitorit- në këtë rast debitorit.

I autorizuari i palës ankuese ka deklaruar se nuk janë të vërtetat deklaramet e të autorizuarit të palës – përmbaruesit privat se përmbaruesja private ka bërë afishimin e shkresave të lëndës të përmbarimit si dhe të urdhërit të përmbarimit.

Komisioni disiplinor pas vlerësimit të provave të shqyrtimit të të njëjtave si dhe dëgjimit të gjitha palëve në procedurë, ka vendosur që ndaj , ti

shqiptohet masa disiplinore me dënim me gjobë në të holla në shumën prej 1.000.00 (njëmijëeuro), sa është përmendur në dispozitiv të këtij vendimi për shkak se është përgjegjës për shkelje disiplinore nga neni 365 par. 1 të LPP-së. E cila masë është në proporcion me shkeljen e kryer disiplinor dhe e mjaftueshme tani për tani, dhe se kjo masë do të shërbejë përmbaarueses private si organ përmbaarues në këtë çështje përmbaarimore që të jetë në të ardhmen më e kujdesshme, tu përmbahet në përpikëri zbatimit të dispozitave ligjore gjatë zbatimit të përmbaarimit, në cilën do çështje përmbaarimore që do të paraqitet para përmbaarueses.


Andaj më sa u tha më lartë e duke vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 365 par.1, neni 367 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.10 të LPP-së, dhe nenit 368 par. 1, pika 1.3 dhe par. 3 të LPP-së komisioni disiplinor vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT

DPL. nr. 04/2020 të dt. 23.06.2020

Kryetari i Komisionit Disiplinor

Xhemil Elshani



KËSHILLI JURIDIK : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar sipas nenit 374 par. 5 të LPP-së.